


Ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat (NSh) në bujqësinë Kosovare 2003

Rezultatet nga kursi STAC

Grafiku. Vlera e Makinerisë (Euro)



Përmbajtja

Faqe

Përmbledhja e rezultateve	1
Historiku	1
Metodat dhe kualiteti i të dhënave	1
Rezultatet	3
Aneks: Pyetësi	9

Përmbledhja e rezultateve

Me Anketë u siguruan 112 përgjigje prej Sektorit të Ndërmarrjeve Shoqërore, por vetëm 37 janë aktive, prej të cilave 28 në bujqësi. Sipërfaqja e tokës është 67 000 ha, por mund të ketë disa mos-përfshirje të NSh-ve. Kulturat kryesore janë rrushi i verës dhe elbi i birrës. Mekanizimi kryesor i përdorur janë trektorët e mëdhenjë dhe kombajnmat. Ato kanë 2 700 të punësuar me orar të plotë dhe rreth 300 punëtor sezonal. Ka shumë pak bagëti.

Sa i përket sipërfaqeve me kultura dhe bagëtisë, sektori i NSh-ve është i vogël në krahasim me sektorin e ekonomive shtëpiake. Ndërmarrjet shoqërore marrin pjesë me sipërfaqe të kulturave prej 5 000 ha, gjersa sektori i ekonomive shtëpiake ka më tepër se 200 000 ha.

Historiku

Për sektorin e ekonomive shtëpiake rezultatet janë publikuar që nga viti 2000, gjersa për sektorin e NSh-ve nuk ka rezultate në dispozicion pas luftës.

Në vitin 2001 një anketë për NSh-të është realizuar nga ESK, por përgjigja nuk ka qenë e mjaftueshme. Kështu që rezultatet nuk janë publikuar.


Kjo anketë është realizuar si një kurs STAC. Për një javë në Maj dhe një javë në Shtator një grup prej 10 vetëve kanë punuar së bashku. Aty kanë marr pjesë dy mësues prej Suedisë, tre pjemarrës nga MBPZhR dhe pesë pjesëmarrës nga ESK. Ndërkaq ESK është dashur të administroj pjesën e intervistimit.

Metodat dhe kualiteti i të dhënave

Definicioni i NSh-së në këtë anketë

Të gjitha ndërmarrjet bujqësore me prodhimtari bujqësore kanë qenë të përfshira në këtë regjistrim së bashku me ndërmarrjet dhe kooperativat tjera që kanë makineri dhe aktivitet. NSh-të që nuk kanë tokë ose bagëti, dhe disa kooperativa shërbyese nuk janë përfshirë.

Korniza



Për përgatitjen e kornizës është përdorë lista e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) që ka përfshirë 150 NSh/Kooperativa. 37 prej tyre nuk janë përfshirë pasi që ka qenë e qartë se nuk kanë pasur tokë e as bagëti. Të tjerat, 113 syresh, kanë paraqitur kornizën tonë në pranverë, ndërsa 3 të tjera janë shtuar më vonë. Gjithsej numri në kornizë është 116. Prej tyre 112 janë intervistuar. 4 të mbeturat nuk i janë përgjigjur kësaj ankete. Ato janë kontaktuar me telefon. Dy prej tyre nuk kanë tokë, gjersa e treta i ka 41 ha tokë. Ne nuk kemi informata për të katërtën.

Pyetësi

Pyetësi është punuar në Maj në kursin STAC, bazuar në pyetësin për NSh të vitit 2001 dhe pyetësit e përdorur për anketat e ekonomive shtëpiake bujqësore. Pyetësi pastaj është ndryshuar pak dhe është përfunduar në Qershor. Pyetësi është dhënë si shtojcë në fund të këtij raporti.

Grumbullimi dhe përfshirja e të dhënave

Intervistat janë realizuar në periodën Qershor-Gusht 2003. Intervistat kryesisht janë kryer nga zyrtarë statistikore regjionale në Kosovë. Të dhënat janë përfshirë dhe edituar në Access, sikurse edhe anketat e tjera të ESK-së.

Pastrimi i të dhënave dhe tabelimi

Kursi STAC i ka zhvendosur të gjitha të dhënat në Excel dhe llogaritjet i ka kryer në Excel. Para kësaj, disa mos-përgjigje parciale janë hequr, dhe disa vlera shumë ekstreme janë ndryshuar.

Cilësia e të dhënave

Mund të jenë disa mos-përfshirje – disa NSh mund të mos jenë përfshirë në kornizën tonë. Ne kemi gjetur një mos-përfshirje të mundshme prej rreth 600 ha, mirëpo mund të ndodhë që më tepër kooperativa të mungojnë në Kornizë. Mbi-përfshirja është eliminuar. Në fillim kanë qenë 150 NSh/Kooperativa por pasi janë hequr disa Nsh dhe kooperativa shërbyese dhe NSh-të që kanë qenë pjesë të NSh-ve tjera korniza përfundimtare ka përfshirë 113 NSh. Tri NSh janë shtuar më vonë. Si rrjedhojë numri përfundimtar i NSh-ve në kornizë ishte 116.

Mund të paraqiten gabime në përgjigjet për madhësitë ose gabime në përpunimin e të dhënave. Megjithatë, ne kemi bërë kontrollime logjike dhe verifikime përmes pjesëmarrësve të kursit që jetojnë në të njëjtat komuna ku janë edhe NSh-të. Kështu që ne mendojmë se në të dhëna nuk kanë mbetur gabime të mëdha.

Rezultatet

Anketa mori 112 përgjigje prej sektorit të NSh/Kooperativave, por vetëm 28 janë aktive në bujqësi dhe 9 janë NSh/Kooperativa shërbyese aktive.

Tabela 1. Sipërfaqja sipas tipit të tokës dhe statusit (ha)

Tipi i tokës	Aktiv	Jo aktiv	Gjithsej
Oborr	285	216	501
Ara	7337	1209	8546
Kopshte	0	3	3
Sera	18	0	18
Livadhe	800	231	1031
Kullosa	23398	184	23582
Pemishte	484	75	559
Vreshta	2178	54	2232
Pyje	3986	132	4118
Djerrinë	15572	11040	26612
Hurdha peshqish	9	9	18
Të tjera	5	3	8
Gjithsej	54072	13156	67228

Sipërfaqja e tërësishme e NSh-ve është rreth 67 000 ha dhe rreth 80% e tokës i takon NSh-ve aktive. Rreth 10% e tokës është e uzurpuar.

Tabela 2. Sipërfaqja sipas tipit dhe pronësisë (ha)

Tipi i tokës	Në pronësi	Me qira*	Gjithsej
Oborr	462	39	501
Ara	6475	2072	8547
Kopshte	3	0	3
Sera	18	0	18
Livadhe	756	274	1031
Kulloso	23537	45	23582
Pemishte	559	0	559
Vreshta	2223	9	2232
Pyje	4118	0	4118
Djerrinë	26248	363	26612
Hurdha peshqish	10	8	18
Të tjera	8	0	8
Gjithsej	64417	2811	67228

*) dhe tjera

Pothuajse e tërë toka është në pronësi të NSh-ve.

Tabela 3. Sipërfaqja e ujitur sipas tipit (ha)

Tipi i tokës	E ujitur	E pa ujitur	Gjithsej
Oborr	10	491	501
Ara	1479	7068	8547
Kopshte	3	0	3
Sera	6	12	18
Livadhe	61	970	1031
Kulloso	0	23582	23582
Pemishte	31	528	559
Vreshta	0	2232	2232
Pyje	0	4118	4118
Djerrinë	125	26487	26612
Hurdha peshqish	0	18	18
Të tjera	0	8	8
Gjithsej	1715	65513	67228

Sipërfaqet më të mëdha për ujitje janë arat dhe tokë të lëna djerrinë.

Tabela 4. Arsyet pse toka është lënë djerrinë (ha)

Arsyeja	Area
Mungesa e inputeve	259
Mungesa e fuqisë puntore	1,3
Mungesa e pajisjeve	215
Fitimi i ulët ekonomik	472
Gjithsej	947,3

Arsyet kryesore për të lënë tokën djerrinë janë përfitimi i ulët ekonomik dhe mungesa e inputeve. Këto janë sipërfaqet për të cilat NSh/Kooperativat janë përgjegjës në pyetjen pse toka është lënë djerrinë, sepse sipërfaqet e lëna djerrinë janë më të mëdha.

Tabela 5. Makinaria

Tipi i makinës	Numri i makinave	Vlera	Mirëmbajtja
Traktor i madh	142	582907	55680
Traktor i vogël	28	96000	8429
Motokultivator	7	9240	300
Pllug	170	54063	3197
Lesë me disqe	45	35950	770
Trinë e dhëmbëzuar	22	6650	450
Rimorkio	102	95953	2890
Makinë mbjellëse	54	44783	1117
Makinë frezuese	6	4600	0
Makinë mbjellëse në rreshta	40	16340	1160
Spërkatës	27	23750	1030
Makinë kositëse	9	3250	200
Makine-grabujë për bar	6	1150	30
Makine për terjen e barit	3	8000	400
Kombajn korrëse	68	422300	22566
Lidhëse e ushqimit të kafshëve	11	31600	1020
Mulli	3	10500	30
Pompa uji	6	10000	1300
Aparat për mjelje	3	2100	250
Kombajna silazhi	3	21000	2000
Kombajna të tjerë	1	5000	400
Adapter për misër	2	3250	0
Adapter për lulediell	5	5200	730
Mjet rigrumbullues	3	150	0
Shpërndarës plehu organik	2	1000	0
Kultivator në mes rreshtave	17	8290	525
Makinë sillazhi	1	500	0
Kombajn për panxhar sheqer	2	3100	500
Vjelëse e misrit	1	600	600
Nxjerrëse e patateve	3	600	0
Linja e makinave për patate	31	17400	1850
Rrëminjës	2	400	0
Gjithsej		1525626	107424

Si shtesë, për lëndët djegëse dhe lubrifikante janë shpenzuar rreth 250 000 €
Vlera e makinerisë së NSh-ve është rreth 1,5 milion €

Në grafikun 1, janë paraqitur makinat me vlerën më të lartë të përgjithshme.

Grafiku 1. Vlera e Makinerisë (Euro)




Tabela 6. Kulturat e mbjellura – kultivuara (ha)

Kulturat	Sipërfaqja
Grurë	506,0
Thekër	2,0
Elb	314,0
Elb birre	1657,6
Tërshërë	9,0
Miser	7,0
Patate	8,5
Domate	1,0
Tranguj	4,0
Hudhëra	1,0
Bari i përzier	15,0
Urov	109,0
Mollë	22,0
Dardhë	6,2
Ftua	0,3
Kumbull	18,6
Vishnje	235,0
Lajthi	148,0
Rrush	304,1
Rrush vere	1919,0
Lulediell	180,0
Sojë	11,0
Fidane pemësh	1,0
Fidane për bimë dekorative	0,2
Gjithsej	5479,4

Sipërfaqet më të mëdha janë të mbuluara me hardhi rrushi për verë, elb për birrë dhe grurë.

Në grafikun 2 (poshtë) mund të shihet se grupet më të shpeshta të kulturave janë drithërat dhe pemët.

Grafiku 2. Sipërfaqet sipas kulturave (ha)




Table 7. Farërat

Kulturat	Përdorur (kg)	Blerë (kg)	Vlera e sasisë së blerë (€)
Grurë	142410	141250	48677
Thekër	600	0	0
Elb	67650	67650	26129
Elb birre	320550	328950	123869
Tershërë	1800	1800	400
Misër	123	63	79
Patate	10500	1000	500
Domate	1,3	1,3	9,62
Tranguj	5,2	1,2	7
Hudhëra	700	0	0
Jonxhë	450	0	0
Lulediell	3650	3650	2595
Sojë	1500	1500	900
Gjithsej			203166

Shumica e farërave janë përdorë për drithëra. Tek elbi i birrës sasia e blerë është pak më e lartë se sasia e përdorur në vitin 2003.

Përdorimi i fidaneve ka qenë shumë i vogël, vetëm tri NSh kanë përdorë fidane për kultivimin e ndonjë kulture.

Vetëm dy NSh kanë mbarështuar ose mbajtur kafshë gjatë 12 muajve të fundit. Njëra NSh kryesisht merret me dele e tjetra me pula.

Dy NSh kanë hurdhë peshqish.

Tabele 8. Përgatitja shkollore e të punësuarve sipas gjinisë

Përgatitja shkollore	Mashkuj	Femra	Gjithsej
Pa shkollë	199	6	205
Shkolla fillore jo e kryer përfunduar	306	0	306
Shkolla fillore e kryer	790	26	816
Shkolla e mesme e kryer	899	112	1011
Shkolla e lartë e kryer	109	7	116
Fakulteti i kryer	193	15	208
Gjithsej	2496	166	2662

NSh-të kanë rreth 2 700 punëtor. Më pak se 10% e punëtorëve janë femra.

Ato kanë angazhuar 292 punëtorë sezonal që kanë bërë 16 616 orë pune. Ky numër i vogël vjen si rezultat i faktit se shumica e NSh-ve nuk janë aktive.